



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1173/ 7 prot

Datë 28.05.2025

V E N D I M
Nr. 713/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.05.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Laviva Technologies*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-45444-04-17-2025, me objekt “*Blerje materiale elektrike*” me fond limit: 1.660.700 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.
Adresë: Pranë Stadiumit Himarë

Ankimues: Operatori ekonomik “*Laviva Technologies*” SHPK me NIPT M01323012A me adresë: Rruga “*At Zef Valentini*”, Kompleksi Magazina, Kati 1, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “*Qamil Doka*” PF, me NIPT L81924026A, me adresë: Rruga “*Kadillari*”, Magazina Nr. 47, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.04.2025, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-45444-04-17-2025, me objekt “Blerje materiale elektrike” me fond limit: 1.660.700 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

II.2. Në datën 28.04.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 02.05.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “Ervin Luzi” PF	1,289,000	lekë	skualifikuar
2- “Laviva Technologies” SHPK	1,522,750	lekë	skualifikuar
3- “Sark” SHPK	1,532,900	lekë	skualifikuar
4- “Nika Trading Sa” SHPK	1,549,750	lekë	skualifikuar
5- “Qamil Doka” PF	1,618,000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 02.05.2025, operatori ekonomik “Laviva Technologies” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

Nuk ploteson specifikimet teknike konkretisht:

- mungon klasi i energjisë, kursimi A++
- mungon efienca në punë më shumë se 90%
- mungon garancia e produktit
- voltazhi në hyrje nuk është në parametrat e kërkuara në DT (AC85- dhe në dalje 265V)
- përmasat e ndriçuesit nuk janë brenda parametrave të kërkuar në DT.

II.5. Në datën 05.05.2025, është Publikuar “Njoftim – Fituesi Paraprak”, i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 06.05.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5293, datë 06.05.2025, dhe me nr. 1173/2025 prot, datë 06.05.2025 e operatorit ekonomik “Laviva Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-45444-04-17-2025, me objekt “Blerje materiale elektrike” me fond limit: 1.660.700 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Laviva Technologies” SHPK dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Qamil Doka” PF me përmbajtje si vijon:

Shoqëria jonë “Laviva Technologies” SHPK pretendon se ka shkelje në analizen nga komisioni perkates pasi mostra e paraqitur i ploteson kriteret sipas specifikimeve teknike. Në bazë të përvjes me ekspert të fushës, konkluzioni ynë është i tillë: Klasi i energjisë A++ dhe parametri

100 lumen/wat janë në kontradiktë me njëra-tjetrën pasi formula e efikasitetit është fluksi përmbi fuqinë, pra specifikisht për produktin tone është 10000 lumen dhe 100 Wat, pra efikasiteti i produktit tone është 100 lumen/ëat pra aq sa është kërkuar nga vete institucioni. Klasa e energjisë sipas klasifikimit të Bashkimit Europian (EU) paraqitet e tillë: Produktet me parametra mbi 210 lumen/ëat klasifikohen si klase A++. Në vlerën e kërkuar nga institucioni pra 100lumen/ëat, është klasa F pra e nënkupton këto klase energjie duke paraqitur eficienten e kërkuar me siper. Kjo bie ndesh me kërkesat tuaja të parametrave të paraqitur duke krijuar paqartësi në kërkesë. Pra klasi i energjisë nuk është i mundur në bazë të parametrave që institucioni ka paraqitur.

Gjithashtu operatori ekonomik që është shpallur fitues, Qamil Doka ka paraqitur një produkt nga një brand kinez Ehb mt, i cili gjithashtu nuk i plotëson parametrat e kërkuar pasi nuk mund të plotësohet klasën e energjisë A++ kur në fakt ka kërkesë për efikasitet 100 lumen/wat, pra kjo nuk është e mundur të plotësojë të dyja kërkesat njëkohësisht.

Si përfundim pretendojmë se “Laviva Technologies” SHPK nuk ka arsye të skualifikohet nga procedura për mospërbushje të kriterëve të specifikimeve teknike pasi produkti i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Për sa më sipër kërkojmë të kualifikohemi në këto procedure tenderi dhe të ribehet Vlerësimi i Ofertes.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1173/1 prot., datë 07.05.2025, janë publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues si dhe kriteret të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Qamil Doka” PF, të cilat i kundërshton me anë të ankesës me nr. 1173/2025 prot, datë 06.05.2025.

II.8. Me shkresën nr. 184/15 prot, datë 15.05.2025, (ardhur nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike), protokolluar me tonën me nr. 1173/2 prot, datë 19.05.2025, me objekt: “Kthim – Përgjigje”, autoriteti kontraktor ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës nr. 184/14 prot, datë 14.05.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga verifikimi i të cilës rezulton, se ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues me pretendimin si më poshtë vijon:

Në zbatim të shkresës tuaj nr. 184/13 prot. datë 07.05.2025 morra në shqyrtim ankesën e O.E “Laviva Technologies” shpk të paraqitur për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me objekt: “Blerje materiale elektrike” dhe fond limit 1.660.700 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind) leke pa TVSH. Në shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve Teknike të dokumentave të tenderit është përcaktuar:

Ndriçues rrugor LED 100W duhet të plotësojë këto kritere të shkruara në ambalazhim:

- Klasi i energjisë, kursimi A++
- Te këtë marketimin CE
- Eficienca në punë me shume se 90%
- Të stampuar në ambalazh 1 vit garanci
- Të këtë të specifikuar Indeksin e ngjyrave të lartë (high CRJ)
- 100 lumen për Wat
- Voltazhi në hyrje AC85- dhe në dalje 265V
- Ngjyra e bardhë (ëhite)
- Përmasat e ndriçuesit 26.5 cm i gjerë dhe 59 cm i gjatë

Në shtojcën 8 Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit të dokumentave të tenderit është percaktuar: 2.3.4 Operatori ekonomik, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë muster të artikullit nr. 20 “Ndriçues led 100W” e cila duhet të jetë në përputhje me specifikimet teknike të percaktuara në shtojcën “Specifikimet Teknike” të DST-së.

Mosparaqitja e mostrës jo në kohën e percaktuar si dhe jo sipas specifikimeve teknike perben kusht skualifikimi.

Në procesverbalin e datës 28.04.2025 mbi administrimin e mostrave rezulton se OE ankimues ka paraqitur prodhim të kompanisë “Brika Elektrik”.

Pasi shqyrtova mostrën e OE ankimues dhe e ballafaqova me specifikimet teknike të kërkuara për këtë produkt konstatova se:

- produkti i ofertuar nuk ka në ambalazh dhe as tek mostra garancinë 1 vit;
- produkti i ofertuar nuk ka në ambalazh dhe as tek mostra klasin e energjisë, kursimi A++ e cila siguron kursime me të mëdha të energjisë.
- produkti i ofertuar nuk ka në ambalazh dhe as tek mostra eficienten në punë me shume se 90%. Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është rritja e eficientes së energjisë së ndriçuesit.
- është kërkuar voltazhi në hyrje AC85 dhe në dalje 265V ndërsa është ofertuar AC220V-240V. Pajisjet AC85-265V funksionojnë në të dy sistemet e energjisë 120V dhe 240V kurse produkti i ofertuar nuk punon në të dy sistemet por funksionon në sistemet e energjisë 220 dhe 240V. Ky produkt i ofruar nga ky operator ekonomik nuk është i përshtatshëm për zonat ku është caktuar vendosja e tyre, në të cilat sistemi i energjisë është 120V-240 V.
- përmasat e produktit nuk janë brenda parametrave të kërkuara (gjatësi dhe gjerësi). Ky fakt është i pranuar nga vete OE ankimues duke mos e përmendur të specifikimet teknike të cilat ai pretendon se i plotëson.

Në rast se OE ankimues do të kishte paqartësi në lidhje me dokumentat e tenderit (përfshirë këtu edhe specifikimet teknike) duhet të kishte ushtruar brenda afateve ligjore të drejtën e

ankimimit ose të kerkonte sqarime në lidhje me to. Mosplotësimi i specifikimeve teknike është kusht për refuzimin e ofertes së OE.

Në lidhje me ankesën për kualifikimin e OE “Qamil Doka” PF, duke qene se ky OE ka ofertë me të lartë se oferta e OE ankimues dhe nuk legjitimohet ankesa për një ofertë me vlerë me të lartë se oferta e ankimuesit, vendosa mosmarrjen në shqyrtim të kësaj pike të ankesës (ky është dhe qëndrimi i KPP në raste të njëjta ankimesh).

Sa më sipër rezulton se vendimi i K.V.O. për skualifikimin e ofertes së këtij O.E. është i drejtë prandaj vendosa refuzimin e ankesës së shoqërisë “Laviva Technologies” shpk.

II.9. Me qëllim shqyrtimit të ankesës të operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 1173/3 prot., datë 20.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor informacion si më poshtë:

Në datën 06.05.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2025/5293, dhe me nr. 1173/2025 datë 06.05.2025, e operatorit ekonomik “Laviva Technologies” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-45444-04-17-2025, me objekt “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 1.660.700 (një milion e gjashtëqind e gjashtë dhjetë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 28.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Laviva Technologies” SHPK dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Qamil Doka” PF, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar vendimi i KSHA-së lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, por mungojnë mostrat e paraqitura në tender nga operatori ekonomik “Laviva Technologies” SHPK dhe operatori ekonomik “Qamil Doka” PF, që përbëjnë në thelb edhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit, gjithashtu kërkojmë të na vihet në dispozicion edhe procesverbali i KVO-së lidhur me marrjen në dorëzim të mostrave, sipas Udhëzimit nr.3, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.

Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Laviva Technologies” SHPK dhe operatori ekonomik “Qamil Doka” PF, shoqëruar me procesverbalin e KVO-së lidhur me marrjen në dorëzim të tyre, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Me shkresën nr. 360/1 prot, datë 26.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1173/4, datë 27.05.2025, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor, së bashku me mostrat e kërkuara në shkresën nr. 1173/3 prot, datë 20.05.2025.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Laviva Technologies” SHPK, mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: “Nuk ploteson specifikimet teknike konkretisht: - mungon klasi i energjisë, kursimi A++; - mungon efica nca në punë më shumë se 90%; - mungon garancia e produktit; - voltazhi në hyrje nuk është ne parametrat e kërkuara ne DT (AC85- dhe në dalje 265V); - përmasat e ndriçuesit nuk janë brenda parametrave te kërkuar ne DT”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet si më poshtë:

Specifikime Teknike:

Nr.	Emërtesa e materialeve elektrike
1	Shtylla metalike 6.8 m
2	Krahë për koka ndriçimi
3	Morseta
4	Kabëll ABC 2x16 mm
5	Kabëll ABC 4x16 mm
6	Tirantues 4x16 mm
7	Tirantues 2x16 mm
8	Konektor 16\95(abonenti)
9	Kabëll CU 2x1.5 mm
10	Kabëll CU 3x2.5 mm
11	Kabëll CU 4x4 mm
12	Kabëll CU 3x6 mm

13	Kabëll CU 4x6 mm
14	Kabëll CU 4x10 mm
15	Kaseta metalike 30x40 cm
16	Kaseta metalike 20x30 cm
17	Shina për kaseta metalike
18	Izolant
19	Klema të ndryshme
20	Ndriçues led 100W
21	Llamba led 20-30W
22	Ndriçues led tavan gipsi f20
23	Ndriçues led tavan gipsi 60x60
24	Automat 1p 16A
25	Automat 1p 20A
26	Automat 1p 25A
27	Automat 1p 32 A
28	Automat 3f+n 16A
29	Automat 3f+n 20 A
30	Automat 3f+n 25 A
31	Automat 3f+n 40A
32	Automat 3f+n 63 A
33	Lëshues 3f+n 20x40A
34	Fotoelement
35	Portollamba 10A
36	Priza shuko brenda murit 2fazor 25A
37	Çelës 2 polar 220V 10A
38	Suport prize (universale)
39	Kapak prize (universale)
40	Drosel 150W
41	Driver 50W
42	Driver 100W
43	Shkallë (3 element 9m)
44	Set vegla (pinca, kacavida etj)

- Autoriteti Kontraktor nuk do të pranojë mallra që nuk plotësojnë kushtet e standartizimit shtetëror të cilat janë të njëjta me ato të Bashkimit Europian, mallrat elektrike duhet të jenë për destinacion e shteteve europiane;
- Mallrat të jenë të ambalazuara me etiketat përkatëse të vendit prodhues të origjinës si dhe në gjuhën shqipe;

Mallrat duhet të dorëzohen të ambalazuara si më poshtë:

- Ambalazhimi të jetë në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportimit.

- Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të markueshëm e të etiketueshëm, të hapen kollaj, të kenë volume të përshtatshme përdorimi dhe etikë në paraqitje.
- Duhet të lexohen me vëmendje rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t'u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.

Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

- Emri i produktit,
- Emri i markës prodhuese, adresa e kompanisë, numri i telefonit, etj
- Data e prodhimit,
- Specifikimet e kërkuara
- Etiketa e vendosur në çdo produkt të kërkuar të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe.

Ndricues rrugor LED 100W duhet të plotësojë këto kriteret të shkruara në ambalazhim:

- Klasi i energjisë , kursimi A++
- Të ketë marketimin CE
- Eficenca në punë më shumë se 90%
- Të stampuar në ambalazh 1 vit garanci
- Të ketë të specifikuar Indeks të ngjyrave të lartë (high CRI)
- 100 lumen për Wat
- Voltazhi në hyrje AC85- dhe në dalje 265V
- Ngjyra e bardhë (ëhite)
- Përmasat e ndriçuesit 26.5cm i gjerë dhe 50.9cm i gjatë

III.1.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostër të artikullit nr. 20 “Ndriçues led 100W” e cila duhet të jetë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën “Specifikimet Teknike” të DST-së.

Mosparaqitja e mostrës jo në kohën e përcaktuar si dhe jo sipas specifikimeve teknike, përbën kusht skualifikimi.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.1.4. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’ përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.1.6. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të

zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.7. Në nenin 80 të Ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, parashikohet se: *“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:*

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi

4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj”

III.1.8. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:


a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

III.1.9. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me

sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues, duhet të paraqesin nga një mostër fizike për artikullin nr. 20 “Ndriçues led 100W” e cila duhet të jetë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Mosparaqitja e mostrës jo në kohën e përcaktuar si dhe jo sipas specifikimeve teknike, përbën kusht skualifikimi.

III.1.10. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, pretendimet e ankimueit, si dhe nga shqyrtimi i mostrës të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, pranë autoritetit kontraktor dhe dorëzuar nga ky i fundit pranë KPP-së me shkresën nr. 360/1 prot, datë 26.05.2025, Komisioni Prokurimit Publik konstatoi, se operatori ekonomik ankimues “Laviva Technologies” SHPK ka dorëzuar 1 mostra për artikullin nr. 20 “Ndriçues led 100W” të kërkuara në kriteret e vecanta të kualifikimit pikën 2.3.4 si më poshtë vijon:

Mostra





Referuar specifikimeve teknike për arikullin nr. 20 “Ndriçues led 100W”, autoriteti kontraktor në shtojcën 6 ka përcaktuar që ky produkt duhet të ketë këto specifikime teknike - Klasi i energjisë, kursimi A++; - Të ketë marketimin CE; - Eficenca në punë më shumë se 90%; - Të stampuar në ambalazh 1 vit garanci; - Të ketë të specifikuar Indeksin e ngjyrave të lartë (high CRI); - 100 lumen për Wat; - Voltazhi në hyrje AC85- dhe në dalje 265V; - Ngjyra e bardhë (ëhite); - Përmasat e ndriçuesit 26.5 cm i gjerë dhe 50.9 cm i gjatë, ndërkohë nga verifikimi i mostrës “Ndriçues led 100W” prodhim i Brika Elektrik të dorëzuar nga operatori ekonomik

shfaqen mangësi në përmbajtjen e specifikimeve teknike si në ambalazhin e produktit ashtu dhe në trupin e produktit të dorëzuar konkretisht nga specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit për produktin “Ndriçues led 100W” mungojnë specifikimet teknike si - Klasi i energjisë, kursimi A++; - Eficenca në punë më shumë se 90%; - Të stampuar në ambalazh 1 vit garanci; - Voltazhi në hyrje AC85- dhe në dalje 265V; - Përmasat e ndriçuesit 26.5 cm i gjerë dhe 50.9 cm i gjatë. KPP gjykon, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri/specifikimi të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Në rastin konkret nga verifikimi i mostrës, rezulton të ketë mangësi të specifikimit teknike ndaj për sa më sipër, Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor për sa i përket specifikimeve teknike të artikullit nr 20 “Ndriçues led 100W”, të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues. Fakti i mosplotësimit të specifikimit teknik, sipas kërkesës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pranohet edhe nga vetë ankimuesi, i cili ngren dhe pretendime se specifikimet teknike të hartuara nga AK bien në kontradiktë me njëra – tjetrën. Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kriteret/specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1/1 e LPP. Në nenin 110 pika 1/1 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt - ankimimi. Në këtë kuptim, Komisioni gjykon, se ankimuesi në kushtet kur nuk mund të përmbushë kërkesat e autoritetit kontraktor, është i destinuar të dështojë në realizimin me sukses të kësaj kontrate, kjo pasi malli që ky ofertues do të ofrojë, nuk do të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Për sa i përket arsyes së skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik pasi vlerësoi verifikimin e mostrën e dorëzuar dhe specifikimet teknike të artikullit të sipërcituar rezultoi se arsyet e skualifikimit të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike qëndron, pasi ankimuesi shfaq mangësi në përmbushjen e të gjitha specifikimeve teknike pra nuk i përmbush ato. KPP gjykon, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri/specifikimi të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Pra për sa më sipër, KPP gjykon, se mostra e paraqitura nga operatori ekonomik “Laviva Technologies” SHPK, nuk i përmbushin të gjitha specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në

pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“[...]1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.. [...]”.

Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Laviva Technologies” SHPK, për operatorin ekonomik “Qamil Doka” PF Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1.10, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Laviva Technologies” sh.p.k edhe pas ankimit do të vijojë të ngelet i skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

III.2.1. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit

kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t'u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.2.2. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Laviva Technologies*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-45444-04-17-2025, me objekt “*Blerje materiale elektrike*” me fond limit: 1.660.700 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 28.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Laviva Technologies*” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

